

PROCESET E GLOBALIZIMIT DHE ROLI I SHQIPES STANDARDE NË RUAJTJEN E GJUHËS DHE TË ETNISË NË BASHKËSITË GJUHËSORE SHQIPTARE

Ferit Rustemi

Universiteti i Europes Jug-Lindore, Tetovo, Macedonia. Email: f.rustemi@seeu.edu.mk

Abstract

Gjuhët kur vijnë në kontakt societal dhe kulturor nuk mbeten të pandryshuara, ato pësojnë ndryshime si në formë, ashtu edhe në funksionet gjuhësore. Me fjalë të tjera, proceset e globalizimit paraqesin rrezik jo vetëm për gjuhët, por edhe për mbijetesën e kombeve dhe të bashkësive etnike të vogla. Andaj, ruajtja e gjuhës shqipe dhe etnisë shqiptare nga rreziqet që i kanosen jo vetëm nga proceset e globalizimit është jashtzakonisht e rëndësishme për shkak të shumdimensionalitetit të tij; ai ngërthen në vete dimensionin societal, politik, kulturor dhe gjuhësor, madje do të thoja, është çështje mbi çështjet kur është fjala për mbijetesën e kombit shqiptar. Tashmë jemi dëshmitarë të procesit të tkurrjes dhe të vdekjes së gjuhës shqipe jo vetëm në diasporë, në Greqi, në Italinë Jugore, në Turqi, por edhe në arealin kompakt të gjuhës shqipe në rajonin e Rozhajës, të Gucisë dhe të Plavës në Malin e Zi, në viset perëndimore dhe periferike shqiptare të Maqedonisë. Objektivi i këtij punimi është identifikimi i problemeve aktuale, përkufizimi i qëllimeve të planifikimit gjuhësor dhe të ofrojë zgjidhje për përmbushjen e objektivit të sipërshënuar. Mjeti me anë të së cilit do të bëhet përkufizimi i qëllimit në fjalë në këtë studim janë funksionet gjuhësore, meqë idealisht një gjuhë kombëtare duhet t'i përmbushë të gjitha funksionet gjuhësore.

Keywords: *globalizimi, societal, funksion gjuhësor, dimension, identifikimi*